

Halim Haziraj, Zyrtar për buxhet dhe financa

**PROCESI I BUXHETIMIT DHE
PROCEDURAT E BRENDSHME
TË UPZ
LIDHUR ME BUXHETIMIN**

Prill 2016

I. TË DHËNA TË PËRGJTHSHME LIDHUR ME PROCESIN E BUXHETIMIT TË UPZ

Universiteti Publik i Prizrenit është themeluar në bazë të **Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/87, datë 09 tetor 2009.**

Me 30 Maj 2013 miratohet Statuti i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, në bazë të të cilit punohet edhe sot.

Në fillim të këtij viti është emëruar Prorektori për Financa dhe Infrastrukturë i UPZ, që është në këtë pozitë edhe aktualisht.

UPZ nuk ka të punësuar Zyrtar për buxhet, edhe pse Operatorët tjerë ekonomik punësojnë zyrtar të posaçëm të buxhetit.

UPZ ka funksionuar dhe funksionon edhe më tej si nën-program i MASHT.

Si nënprogram, UPZ i ka disa **kufizime** në procedurat e buxhetit të cilat nuk i kanë operatorët të cilët janë programe në vete.

Kufizimi kyç është se, përs a i përket buxhetimit, nën-programet nuk i mbajnë relacionet e drejtëpërdrejta me MEF por ato, si rasti i UPZ, i mbajnë në mënyrë të tërthortë- nëpërmjet MASHT.

Aktivitetet buxhetore për vitin që pason fillojnë që nga fundi i marsit të vitit vijues. Kështu për vitin buxhetor 2017, kërkesat fillestare paraqiten që në mars të vitit 2016.

Rëndom, sipas përvojës së gjertanishme, kërkohet që kërkesat buxhetore të bëhen brenda kufijve (limiteve) të cilat i përcakton MASHT (për ata që janë të pavarur-MEF), kështu që edhe sot nuk e kam të qartë nëse limitet që i përcaktohen UPZ-së janë limite të MEF apo të MASHT.

Mendoj se janë limite të këtij të fundit.

Kërkesat e reja kërkohej që të bëhen si “kërkesa shtesë”, të cilat, zakonisht nuk merren parasysh dhe “aprovohen” vetëm ato sipas limiteve.

“Limitet” e përcaktuara e kanë një bazë- e ajo është SHPENZIMI I BUXHETIT në vitet e mëparme. Baza e këtillë i ka argumentet e veta (“nuk ju nevojiten më shumë para sepse nuk i shpenzoni”) por nuk e merr parasysh faktin se Operatorët e rinj (si UPz etj.) nuk e kanë arritur ende nivelin e “stabilizimit”-rritjes, as përsa i përket nevojave për staf, as përsa i përket nevojave për furnizim me mallra dhe shërbime dhe ka vazhdimisht kërkesa të reja për Subvencione dhe transfere dhe Shpenzime komunale-PËR SHKAK TË RRRITJES SË UNIVERSITETIT.

Shënim: Është e logjikshme që të pritet se me hapjen e universiteteve të reja të bie numri i studentëve në UP (dhe të zvogëlohet buxheti i UP dhe numri i stafit aty), dhe është e logjikshme që të pritet që të rritet numri i studentëve në Universitet e reja (dhe numri i stafit dhe buxheti për ato).

II. BUXHETI I LEJUAR SIPAS VITEVE NË UPZ

Kat. ekon.	2013	2014	2015	2016	2017
Pagat	1,470	1,550	1,509	1,619	1,822
Mallra	774	783	646	600	790
Komunale	83	84	53	53	75
Subvenc.	45	50	10	10	90
Kapitale	1,300	500	85	500	800
Nr.i punët.	130	130	139	139	150
Gjithsej:	3,671	2,967	2.303	2,782	3,577

Shënim: Shihet tendenca për zvogëlimin e buxhetit për Mallra dhe për Shpenzime komunale, që nuk mund të arësyetohet në asnjë mënyrë.

Në vitin 2015 nuk kemi pasur fonde të mjaftueshme për pagesën e energjisë së shpenzuar.

Gjithashtu shihet tendenca e ndarjeve të pamjaftueshme Buxhetore për Subvencione dhe transfere.

*Stafi është marrë nga UP-profesorët PA BUXHET!

Shënim: Limiti bazë buxhetor për vitin 2017 është me të kaltër!

Logjikisht duhet të pritet që kërkesat buxhetore tonat të

“negociohen”, çka zakonisht nuk ndodh.

Zakonisht, formohet një komision i MASHT, të cilin e kryeson S/P i MASHT, që e “lejon buxhetin” për vitin e ardhshëm.

Për vitin buxhetor 2016 UPZ nuk e ka nënshkruar (s’e ka pranuar) buxhetin e aprovuar, që e bënë një Komision i formuar në MASHT, në të cilin UPZ nuk ka pasë asnjë përfaqësues.

III. PROCEDURAT E BRENDSHME TË CILAT (DUHET) NDJEKUR LIDHUR ME BUXHETIMIN

Me Statutin aktual të UPZ, Këshilli Drejtues i UPZ është **organi kryesor qeverisës i UPZ-përgjegjës për financa.**

Natyrisht që përgjegjësinë kryesore e kanë edhe menaxhmenti i UPZ (Rektori, Prorektori për financa, Sekretari dhe zyrtarët për financa.

Me ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, përgjegjësit kryesor lidhur me shpenzimin e buxhetit janë:

- a) Zyrtari Kryesor Administrativ;
- b) Auditori i brendshëm;
- c) Zyrtari kryesor financiar;
- d) Zyrtari i prokurimit, dhe
- e) Zyrtari certifikues

IV. PROCEDURAT LIDHUR ME BUXHETIMIN E PAGAVE TË PERSONELIT

Lidhur me buxhetimit e pagave të personelit, problemet kyç që paraqiten janë planet e zhvillimit të UPz në vitet në vijim.

Në këtë pikë duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë në mes të Njësive të UPZ (Dekanët, Sekretarët e fakulteteve) në mënyrë që t'i bëjnë planet e zhvillimit të fakulteteve, t'i shqyrtojnë në organet gjegjëse të UPZ (Këshill Drejtues, Senat, Menaxhment) dhe me ato plane të njoftohet shërbimi financiar për t'i përpiluar kërkesat për numër të punëtorëve dhe për fonde.

Punët tjera janë rutinë e shërbimit financiar-të cilat kryhen në bazë të përvojës nga vitet e kaluara dhe që bazohen në rezultate të analizave financiare (mesatarja e pagave për staf akademik; staf civil, kërkesat monetare në bazë të planeve të zhvillimit etj.).

V. PROCEDURAT LIDHUR ME BUXHETINIM PËR MALLRA DHE SHËRBIME

Procedurat lidhur me këtë kategori ekonomike janë më të thjeshta: Ato mund të bëhen nga shërbimi–në bazë të përvojës lidhur me shpenzimin e buxhetit në vitet e kaluara dhe analizave të shërbimit.

Eventualisht, nevojitet bashkëpunimi i fakulteteve lidhur me kërkesat Sipas kodeve ekonomike, ashtu siç provuam ta bëjmë për vitin 2016.

VI. PROCEDURAT LIDHUR ME BUXHETIMIN SHPENZIMEVE KOMUNALE DHE PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Për këto dy kategori ekonomike është e mjaftueshme përvoja nga vitet e kaluara (pak a shumë janë të njohura shpenzimet për Rrymë, Ujë, Mbeturina dhe ato të Telefonit) si dhe niveli i bursave për një vit akademik).

VII. INVESTIMET KAPITALE

Për këtë kategori ekonomike me rëndësi të dorës së parë është pjesëmarrja e menaxhmentit të lartë pasi që këtu financohen PROGRAMET (dhe, nëse ekzistojnë, PROJEKTET), për të cilat ekskluzivisht vendosë menaxhmenti i UPZ (Ndërtime, rindërtime, automjete, laboratorë etj.).

VIII. PËRFUNDIME- GJENDJA AKTUALE NË UPZ

Me **Ligjin për menaxhimin e financave publike....** është precizuar se Zyrtarët financiar të O.B., përgjegjës për afarizmin financiar të O.B. janë:

- ▶Zyrtari Kryesor Administrativ;
- ▶Auditori i brendshëm;
- ▶Zyrtari kryesor financiar;
- ▶Zyrtari i prokurimit, dhe
- ▶Zyrtari certifikues

Në fund të viti 2015 janë kryer edhe disa Parapërgatitje teknike lidhur me pavarësimin financiar të UPZ (është krijuar lidhja për qasje në FREE-Balance), gjë që e ka lehtësuar punën në shërbimin e financave

Në fillim të këtij viti janë krijuar edhe dy lidhje për qasje në Free-balance dhe janë certifikuar për punë në këtë aspekt:

- ▶ Zyrtari certifikues;
- ▶ Zyrtari zotues;
- ▶ Zyrtari shpenzues;
- ▶ Zyrtari i pranimit të mallit;
- ▶ Zyrtari i të hyrave;
- ▶ Zyrtari i pasurisë dhe asetëve, dhe
- ▶ Zyrtari raportues

Natyrisht, për të gjitha këto çështje që u përmendën me sipër (edhe të tjera që nuk munda t'i përmbledh në këtë prezantim të shkurtër) është diskutuar nëpër workshop-et e organizuara nga ky projekt (FAITH), që kanë ndihmuar shumë që të mund të konstatojmë se UPZ është plotësisht i përgatitur nga aspekti i kuadrove që ta kryej funksionin e tij financiar në mënyrë të pavarur.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj